

Kontratë Sipërmarrje - Punë Publike me Objekt:
"Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit"

77
04.08.2014



Vëntetojme se është i njëjti me dokumentin original që ndodhet në Arkivën e Bashkisë Mallaburster Sp. Arkivës: Envis Malaj

dt. 13.11.2018.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BALLSH**

Adresa: Lagjia "18 Prilli", Ballsh, Tel: 00355 313 22 113

Nr. 803 Regj.

Ballsh, më 04/08/2014

**KONTRATË SIPËRMARRJE
PËR PUNË PUBLIKE**

OBJEKTI

"Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit"

PALËT KONTRAKTUESE


**KONTRAKTUESI
JV GRAND KONSTRUKSION M SHPK
& DERVENI-1 SHPK
Përfaqësuar nga
Tetem DAJLANAJ**

GRAND
KONSTRUKSION M
NIPTL38109801T
BALLSH

Reshat ZIKA

**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA BALLSH**

Përfaqësuar nga
**KRYETARI
Ilir CELA**



Kontraktuesi

Autoriteti Kontraktor

Kontratë Sipërmarrje - Punë Publike me Objekt:
“Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”

K O N T R A T Ë

Kjo kontratë është nënshkruar në Ballsh, sot më datë 04 . 08 . 2014, ndërmjet:

- ♦ **BASHKISË BALLSH**, përfaqësuar nga Titullari i saj Z. Ilir ÇELA, që më poshtë do të quhet **“AUTORITETI KONTRAKTOR”**,
- dhe
- ♦ **“Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë (JV) “GRAND KONSTRUKSION M” SHPK** me NIPT L38109801T me adresë Ballsh, Mallakastër & **“DERVENI-1” SHPK** me NIPT K49322548U, me adresë Tepelenë”, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë GRAND KONSTRUKSION M SHPK Z. Tetem DAJLANAJ, që më poshtë do të quhet **“KONTRAKTUESI”**

Shoqëritë **“GRAND KONSTRUKSION M” SHPK & “DERVENI-1” SHPK** me anë të akt-marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm (Join Venture) lidhur më datë 24.06.2014 me nr.777 rep, nr.478 kol, në Ballsh, kanë rënë dakord të bëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit “Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”, ku shoqëria **“GRAND KONSTRUKSION M” SHPK** do të realizojë 66 % të të gjitha punimeve sipas zërave të preventivit, ndërsa shoqëria **“DERVENI-1” SHPK** do të realizojë 34 % të të gjitha punimeve sipas zërave të preventivit. Me anë të prokurës së posaçme të datës 24.06.2014 me nr.778 rep, nr.479 kol, shoqëria **“DERVENI-1” SHPK** autorizon shoqërinë **“GRAND KONSTRUKSION M” SHPK** me drejues ligjor Z.Tetem Dajlanaj të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit të kontratës.


Palët pjesëmarrëse në këtë marrëdhënie kontraktore bien dakord që **KONTRAKTUESI** të kryejë punimet për të cilat është shpallur fitues në prokurimin publik me objekt “Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, projekt-zbatimin dhe me përcaktimet e kushtet në dokumentat e tenderit të cilat janë pjesë e pandashme e kësaj kontrate.

NENI 1 BAZA LIGJORE

1.1 Kjo kontratë mbështetet në Ligjin nr. 9643, datë 20. 11. 2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshimet përkatëse, V.K.M. nr. 1, dt. 10. 01. 2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshimet përkatëse, KPK dhe KVK në dokumentat standarte të tenderit, Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, në dispozitat e Kodit Civil të R.SH. si dhe cdo dispozitë tjetër që nuk përmendet në këtë kontratë, por që rregullon marrëdhëniet në fushën ndërtimore.


 Kontraktuesi

GRAND
 KONSTRUKSION M
 NIPT L38109801T
 BALLSH





Kontratë Sipërmarrje - Punë Publike me Objekt:

“Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”

NENI 2

PËRBËRJA E KONTRATËS

2.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentat e mëposhtme dhe dokumentat e tjera të tenderit të datës 25.06.2014 duke përfshirë KPK dhe KVK në dokumentat e tenderit;

- i. Formulari i Kontratës i nënshkruar nga palët me dokumentat e tenderit të cilësuar në të.
- ii. Sigurimi i Kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë, lëshuar nga shoqëri sigurimi.
- iii. Oferta teknike dhe ekonomike paraqitur nga Kontraktuesi në tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor, me specifikimet teknike, projektin, preventivin me çmimet për njësi dhe vlerën përkatëse.

NENI 3

OBJEKTI KONTRATËS

3.1 Janë të gjitha Punët për “Sistemimin e rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”, në përputhje me projektin, preventivin e miratuar me zëra e volume dhe specifikimet teknike të pranuar në tender, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate dhe përbëjnë detyrim ligjor për zbatim nga palët në këtë kontratë.

NENI 4

ÇMIMET DHE VLEFTA E KONTRATËS

- 4.1 Çmimet për çdo punim të kryer, objekt i kësaj kontrate jepen në preventivin fitues që i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- 4.2 Çmimet janë fikse dhe të pandryshueshme deri në permbushjen e të gjitha detyrimeve të kontraktuesit sipas objektit të kësaj kontrate.
- 4.3 Vlefta totale e kësaj kontrate është **50'030'415** (pesëdhjetë milion e tridhjetëmijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekë.
- 4.4 Në vlerën totale të mësipërme përfshihet TVSH si dhe të gjitha detyrimet e tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë.
- 4.5 Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.
- 4.6 Vlefta e financimit për vitin 2014 do të jetë 36'673'977 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tremijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë me TVSH. Diferenca do të financohet gjatë vitit 2015, pas çeljes së fondit përkatës.

NENI 5


MËNYRA DHE AFATET E PAGESËS

- 5.1 Pagesa do të bëhet me transfertë bankare brenda 30 ditëve kalendarike nga realizimi i punimeve (data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se punët janë mbaruar).
- 5.2 Pagesa do të bëhet sipas situacionit/situacioneve mujore të faturës të verifikuara dhe të konfirmuara nga Drejtuesi i Projektit (Supervizori), shoqëruar me Faturën Tatimore në numrin e llogarisë bankare të Kontraktuesit _____ në Bankën _____.
- 5.3 Monedha e pagesës do të jetë monedha shqiptare (Lekë).

Kontraktuesi

 NENI-1 sh.p.k
 ndert-proj
 Ekspert
 Tepelone ALBAN

GRAND
 KONSTRUKSION M
 NIPTL 8 0000 T
 BALLSH



Autoriteti Kontraktor

- 5.4 Data e pagesës do të jetë dita që fondet i xhirohen Kontraktuesit nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

NENI 6

AFATI I REALIZIMIT DHE DORËZIMIT TË PUNIMEVE

- 6.1 Kontraktuesi merr përsipër të realizojë dhe të përfundojë të gjitha punimet, sipas grafikut të realizimit të paraqitur në tender dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, për një afat prej **3 MUAJ** nga data e lidhjes së kontratës me Supervizorin.
- 6.2 Dorëzimi i punimeve do të bëhet sipas kërkesave përkatëse të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin e punimeve të ndertimit", si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën ndërtimore.
- 6.3 Kontrata konsiderohet e realizuar pas përmbushjes kënaqshëm të detyrimeve të saj.

NENI 7

SIGURIMI TEKNIK

- 7.1 Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

NENI 8


TË DREJTAT DHE DETYRAT E SIPËRMARRËSIT

- 8.1 Sipërmarrësi (Kontraktori) do të realizojë Projektin e Zbatimit në përputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i përfundojë të gjitha punimet në përputhje me volumet e punës për çdo zë të preventivuar për një periudhë jo më shumë se 3 muaj.
- 8.2 Të sigurojë Kontratën në vlerën 10% të vleftës totale të kontratës para lidhjes së saj.
- 8.3 Të fillojë menjëherë nga puna, pas nënshkrimit të kontratës.
- 8.4 Të caktojë drejtuesin/it teknik të tij, të cilët do të drejtojnë të gjitha punimet për zbatimin e projektit dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtuesin e Projektit (Supervizorin) dhe Investitorin (Autoritetin Kontraktor), duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore të tij/tyre.
- 8.5 Të njohë dhe të respektojë termat e Kontratës së Mbikqyrjes që do të lidhet mndërmjet Drejtuesit të Projektit (Supervizorit) dhe Autoritetit Kontraktor dhe Kontratës së Kolaudimit dhe t'i krijojë kushte normale pune Drejtuesit të Projektit dhe Kolaudatorit.
- 8.6 Të pranojë çdo ndryshim jo thelbësor të miratuar nga Investitori në Projektin e Zbatimit dhe në Preventiv brenda vlerës së Kontratës.
- 8.7 Gjatë kryerjes së punimeve, të njoftojë në kohë dhe zyrtarisht Investitorin për ato raste të mospërputhjes së Projektit të Zbatimit dhe të Preventivit. Deri në paraqitjen zyrtare të qëndrimit të Investitorit për shkak të ngritura, Sipërmarrësi duhet të ndërpresë (pezullojë) punimet.
- 8.8 Periudha e ndërprerjes së punimeve duhet të pasqyrohet në Proces-Verbalin përkatës dhe të vertetohet nga Drejtuesi i Projektit. Periudha e


Kontraktuesi




GRAND
KONSTRUKSION M
NIPTL 28 0326 1
BALL



Autoriteti Kontraktor



Kontratë Sipërmarrje - Punë Publike me Objekt:
"Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit"



ndërprerjes së punimeve për arsytet e shprehura në pikën 8.7 të këtij neni, merret në konsideratë për llogaritjen e afatit të përfundimit të punimeve, duke shtyrë afatin e dorëzimit të punimeve për aq kohë sa zgjat ndërprerja e punimeve.

- 8.9 Të sigurojë vetë transportin, makineritë, fuqinë punëtore, drejtimin teknik dhe bazën materiale të nevojshme në përputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur në tender dhe të paraqesë certifikatat e cilësisë së tyre sa herë që i kërkohet. Nuk i lejohet që rolin e sipërmarrësit t'ia japë një subjekti tjetër.
- 8.10 Të njoftojë me shkrim Investitorin për datën e përfundimit të punimeve dhe kërkesën për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të Objektivit. Ky njoftim duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë para datës së përfundimit të punimeve.
- 8.11 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë së punimeve dhe cilësisë së materialeve gjatë zbatimit të kontratës. Ai duhet të njoftojë Drejtuesin e Projektit dhe Autoritetin Kontraktor për rrethana specifike që mund të ndikojnë negativisht në punë për realizimin e objektivit të kontratës.
- 8.12 Sa herë që jepet njoftimi për difekte, Kontraktori duhet t'i korrigjojë ato brenda kohëzgjatjes së parashikuar në njoftim.
- 8.13 Kontraktori duhet t'i paraqesë Drejtuesit të Projektit një plan-program dhe të përgatisë sipas aprovimeve të tij raportimet për ecurinë e punimeve, kontrollin e cilësisë dhe situacionet për punimet e kryera.
- 8.14 Kontraktori duhet t'i paraqesë Drejtuesit të Projektit dhe Kolaudatorit të gjithë dokumentacionin shkresor të përditësuar dhe përfundimtar, si dhe certifikatat e provave të përdorura në objekt, të cilët mbas verifikimit dhe pranimit i administrojnë në dosjen e objektivit.
- 8.15 Kontraktori duhet të zbatojë kushtet teknike të zbatimit në fuqi.

NENI 9

TË DREJTAT DHE DETYRAT E INVESTITORIT

- 1. Investitori (Autoriteti Kontraktor) duhet t'i bëjë me dije sipërmarrësit emrat e Drejtuesit të Projektit, Kolaudatorit si dhe të çdo personi tjetër të autorizuar.
- 2. Të marrë të gjitha masat përgatitore për lirim të Sheshit të Ndërtimit dhe të lejojë Sipërmarrësin të hyjë në Objekt dhe ta dorëzojë atë me proces-verbal në prani të Supervizorit.
- 3. Brenda datës së hyrjes në fuqi të kontratës, të sigurojë të gjitha lejet e nevojshme ligjore në mënyrë që t'i krijojë kushte pune normale Sipërmarrësit.
- 4. Të miratojë Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Përfundimtar të paraqitur e të miratuar nga Drejtuesi i Projektit (Supervizori).
- 5. Ka të drejtë që për të realizuar më së miri anën funksionale të Objektivit, të bëjë ndryshime jo thelbësore në Projektin e Zbatimit dhe në Preventiv. Ndërtime shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.02.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të shumës origjinal të kontratës.



GRIND
KONSTRUKSION M
NIPTL38109801T
BALLSH



"Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit"

6. Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:
- Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - Korrigjime në materiale
 - Korrigjime në sasi
- Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrëveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrëveshjes.
7. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.
8. Të asistojë në procesin e kolaudimit përfundimtar të Objektivit.
9. Të marrë në dorëzim Objektivin pas kolaudimit përfundimtar.
10. Të vërë në shfrytëzim Objektivin dhe pas përfundimit të Afatit të Garancisë të leshojë Çertifikatën e garancisë së punimeve.
11. Verifikon kryerjen e riparimit të difekteve të ndodhura dhe për ato që nuk janë eliminuar llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlefta e Garancisë së Punimeve.

NENI 10

DREJTUESI I PROJEKTIT (SUPERVIZORI)

- 10.1 Drejtuesi i Projektit (Supervizori) është personi i cili ka lidhur kontratën përkatëse të mbikqyrjes me Autoritetin Kontraktor dhe është përgjegjës për administrimin e kontratës së sipërmarrjes.
- 10.2 Drejtuesi i Projektit nëse zbulon se punimet nuk janë përfunduar plotësisht do t'i japë udhëzime me shkrim Kontraktorit që specifikojnë zërat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar.
- 10.3 Drejtuesi i Projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga Kontraktori dhe duhet të vërtetojë për Autoritetin Kontraktor shumën që duhet t'i paguhet Kontraktorit në bazë të situacionit/situacioneve të marra nga Kontraktuesi.

NENI 11


KORRIGJIMI I DIFEKTEVE

- 11.1 Nëse Kontraktori nuk ka korrigjuar një difekt brenda kohës së specifikuar në njoftim, Drejtuesi i Projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të difektit dhe kjo shumë do të mbahet nga pagesa që i duhet bërë Kontraktuesit derisa difekti të korrigjohet.
- 11.2 Dështimi për të korrigjuar difektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye të mospërmbushjes së detyrimeve në favor të Autoritetit Kontraktor.

NENI 12

MBARIMI DHE MARRJA PËRSIPËR E PUNIMEVE

- 12.1 Kontraktori pas përfundimit të punimeve objekt kontrate, i paraqet Drejtuesit të Projektit dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare të



KONSTRUKSION M
NIPTL381098011
BALLSH



Autoriteti Kontraktor

punimeve të kryera dhe i kërkon atij të lëshojë një certifikatë për mbarimin e punimeve dhe Drejtuesi i Projektit do ta bëjë këtë sapo të konfirmojë se punimet kanë përfunduar plotësisht.

- 12.2 Drejtuesi i Projektit në rast se gjatë kolaudimit zbulon punë të papërfunduara plotësisht ose defekte në punime të cilat janë pasojë e punës jocilësore të Kontraktorit, do t'i paraqesë atij me shkrim dhe do të kërkojë kryerjen dhe riparimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm.

NENI 13 RREZIQET E KONTRAKTUESIT


- 13.1 Nga data e hyrjes në kantier deri në përfundim të punimeve, Kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje, humbje ose dëmtim të pasurisë.

NENI 14 SIGURACIONI

- 14.1 Sipërmarrësi mban përgjegjësi dhe përballon rreziqet për dëmtimin dhe humbjen e materialeve dhe pronës publike e private të të tretëve, plagosjen, dëmtimin apo vdekjen e punonjësve të tij apo personave të tretë nga mosrespektimi i rregullave të sigurimit teknik etj. Sipërmarrësi mban përgjegjësi për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e ndërtimeve.
- 14.2 Minimumi i kërkuar për t'u mbuluar nga sigurimet sipas ligjeve në fuqi janë:
- Sigurimi për dëmtime ose humbje të punëve dhe materialeve.
 - Për dëmtime ose humbje të pajisjeve.
 - Për dëmtime ose humbje të pasurisë, përveç punëve, materialeve dhe pajisjeve.
 - Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

NENI 15 CILËSIA DHE GARANCIA E PUNIMEVE

- 15.1 Kontraktuesi garanton cilësinë e punimeve të veprës në përputhje të plotë me kërkesat teknike.
- 15.2 Punimet e riparimeve të veprës nuk merren në dorëzim nëse nuk do të jenë identike (të njëllajta) me kushtet teknike të miratuara.
- 15.3 Kontraktuesi garanton ruajtjen e treguesve që lidhen me cilësinë e tyre jo më pak se **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e kolaudimit të veprës. Në rast të kundërt Kontraktuesi detyrohet të zëvendësojë gjatë afatit të garancisë së lartpërmendur, me shpenzimet e tij, çdo defekt që lind (objekt i kësaj kontrate), i cili do të jetë objekt reklamimi nga ana e Autoritetit Kontraktor.
- 15.4 Zëvendësimet apo riparimet duhet të bëhen brenda një afati të shkurtër, të shprehur në njoftimin e reklamimit me shkrim të Autoritetit Kontraktor.



NENI 16
GRAND
KONSTRUKSION M
NIPTL38109801T
BALLSH



PENALITETET

- 16.1 Tarifa ditore për dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve përtej afatit 3 mujor do të jetë tarifa ditore e barabartë me 4/1000 e vlerës së kontratës.
- 16.2 Penalitetet do të mbahen nga pagesat ose Garancia e sigurimit të kontratës.

**NENI 17
FORCA MADHORE**


- 17.1 Kontraktuesi do të çlirohet nga përgjegjësia për moszbatimin e detyrimeve kontraktuale që vijnë si rezultat i forcës madhore.
- 17.2 Nëse ndodh një situatë e tillë Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktor. Sipas rastit të veprimit të këtij fenomeni, palët me marrëveshje e mirëkuptim përcaktojnë kushtet dhe afatet e reja praktikisht të arsyeshme për zbatimin e detyrimeve të kontratës.

**NENI 18
ZGJIDHJA E KONTRATËS**

- 18.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - i. Kontraktori dështon në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë.
 - ii. Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.
- 18.2 Autoriteti Kontraktor do t'i japë Kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë 15 ditë kohë që të ndreqë mosplotësimin.
- 18.3 Të gjitha materialet, ngritja e kantierit dhe punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësimin e kushteve të saj.

**NENI 19
SIGURIMI I KONTRATËS**

- 19.1 Shuma e sigurimit të kontratës prej 10 % të vlerës së kontratës do t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 19.2 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve.
- 19.3 Garancia e difekteve do të jetë 5 % e vlerës së kontratës, që do t'i mbahet Sipërmarrësit mbi vlerën totale nga situacioni përfundimtar si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të këtij afati.
- 19.4 Garancia për mbulimin e difekteve që mund të lindin gjatë shkrimit të objektit është 1 vit.


 Kontraktuesi
 Topelene ALP

GR/ND
 KONSTRUKSION M
 NIPTL38109801T
 BALLSH




 Autoriteti Kontraktor

NENI 20

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 20.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim dhe negociata midis tyre.
- 20.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

NENI 21

HYRJA NË FUQI E KONTRATËS

- 21.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës përkatëse të mbikqyrjes së punimeve ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Supervizorit (Drejtuesit e Projektit), i cili do të mbikqyrë kontratën e sipërmarrjes në përputhje dhe në zbatim të Udhëzimit të KM Nr.3, datë 15.02.2001 "Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", me ndryshimet përkatëse.
- 21.2 Data e mësipërme do të shërbejë edhe për llogaritjen e afatit të përfundimit të punimeve objekt kontrate.

NENI 22

DISPOZITA TË FUNDIT


- 22.1 Pjesë e kësaj kontrate është edhe çdo dokumentacion tjetër që përbën ky prokurim edhe pse mund të mos jetë përmendur në këtë kontratë.
- 22.2 Kjo kontratë u përgatit në gjuhën shqipe dhe u firmos nga përfaqësuesit e të dy palëve në 6 (gjashtë) kopje origjinale me përmbajtje identike, prej të cilave Kontraktuesi merr 1 (një) kopje, ndërsa 5 (pesë) kopje depozitohen pranë Autoritetit Kontraktor.

PALËT KONTRAKTUESE

KONTRAKTUESI
JV GRAND KONSTRUKSION M SHPK
& DERVENI-1 SHPK
Përfaqësuar nga
Tetem DAJLANAJ

GR/NO
KONSTRUKSION M
NIPTL 38109801 T
BALLSH

Reshat ZIKA



Kontraktuesi

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA BALLSH
Përfaqësuar nga
KRYETARI
Ilir ÇELA



GR/NO
KONSTRUKSION M
NIPTL 38 0980 1
BALLSH

Autoriteti Kontraktor